



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

Numri: KSC-BC-2020-07
Prokurori k. Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt

Vendos: Gjykatësi i vetëm
Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Pjesëmarrësi parashtrues: Dr. Fidelma Donlon

Date: 28 shtator 2020

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Njoftim për emërimin e mbrojtësit

me një shtojcë konfidenciale

Zyrës së Prokurorit të Specializuar
Xhek Smith

Mbrojtësit të Hysni Gucatit
Xhonathan Ris

1. Në pajtim me rregullën 26(1) të Rregullores ¹, Administratorja informon gjykatësin e vetëm për emërimin e mbrojtësit të z. Hysni Gucati ('z. Gucati').
2. Më 25 shtator 2020, Administratorja caktoi znj. Tamara Buruma si mbrojtëse kujdestare të z. Gucati.²
3. Më 28 shtator 2020, përmes shefit të Zyrës së Mbrojtjes, z. Gucati i paraqiti Administratores kërkesë për emërimin e z. Xhonathan Ris si mbrojtës të tij dhe nënshkroi aktin e përfaqësimit.³
4. Z. Ris është pranuar në Listën e Mbrojtësve të Specializuar në përputhje me rregullat 25(1) dhe 26(1) të Rregullores dhe me Direktivën për Mbrojtësit.⁴
5. Më 28 shtator 2020, Administratorja emëroi z. Ris si mbrojtës të z. Gucati, në përputhje me pjesët 12 dhe 13 të Direktivës për Mbrojtësit.⁵
6. Në të njëjtën ditë, z. Ris informoi shefin e Zyrës së Mbrojtjes se dëshironte që z. Valon Hasani ta ndihmonte atë në cilësinë e bashkëmbrojtësit.⁶
7. Z. Hasani është pranuar në Listën e Mbrojtësve të Specializuar në përputhje me pjesën 18 të Direktivës për Mbrojtësit.⁷
8. Më 28 shtator 2020, Administratorja miratoi z. Hasani për bashkëmbrojtës të z. Gucati, në përputhje me pjesën 18 të Direktivës për Mbrojtësit.⁸
9. Ky parashtrim dorëzohet për protokollim si publik, kurse shtojca 1 e tij si konfidenciale, në përputhje me rregullën 82(1)(b) dhe (3) të Rregullores, duke qenë se përmban të dhëna personale për z. Gucati, përkatësisht adresën dhe numrin e

¹ Rregullorja e Procedurës dhe e Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës, KSC-BD-03/Rev3/2020, sikurse është ndryshuar më 29 dhe 30 prill 2020 ('Rregullorja'); *shih gjithashtu* Ligji nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, 3 gusht 2015, nenet 21(4), 21(5), 34(7) dhe 41(4)(b).

² Njoftim për pranimin në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara, KSC-BC-2018-01/F00135, 25 shtator 2020, para. 3.

³ *Shih* Shtojca 1.

⁴ *Shih* Direktiva për Mbrojtësit, KSC-BD-04, 6 nëntor 2017 ('Direktiva për Mbrojtësit'); Vendim për pranim në Listën e Mbrojtësve të Specializuar, KSC/REG/DEF/0059, 25 tetor 2018.

⁵ *Shih* Shtojca 1; *shih gjithashtu* Direktiva për Mbrojtësit, pjesët 12, 13.

⁶ *Shih* Shtojca 1.

⁷ Vendim për pranim në Listën e Mbrojtësve të Specializuar, KSC/REG/DEF/0102, 20 shtator 2019.

⁸ *Shih* Shtojca 1.

pasaportës së tij, si dhe të dhëna personale për mbrojtësin dhe bashkëmbrojtësin, përkatësisht të dhënat e tyre të kontaktit dhe numrat e pasaportave.

Numri i fjalëve në origjinal: 373

/nënshkrim/
Dr. Fidelma Donlon
Administratore

E hënë, 28 shtator 2020
Në Hagë, Holandë